

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **(203-25-8175-5-1-1)**

Sa i përket tenderit për **(Ndërtimi i objektit të MBPZHR-së, AZHB-së dhe APK-së)**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**BM Group SH.P.K.;**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

VETERNIK,

(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

+38349247680

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

**BEDRI GLLAREVA**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bedri.gllareva@bmgrouprks.com

(Adresa elektronike)

15.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 1.B05 Njoftim per Kontrat
- 2.B58 Njoftimi mbi vendimin e AK 29.05.2026
- 3.Vendimi i Gjykates N&B
4. Raporti\_Ekspertit\_2026 0170
5. Vendimi OSHP 2026 162
6. Sqarimet për OE - Ndertimi i Objektivit të MBPZHR APK DHE AZHB-22.10.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 Qëllimi**

**Neni 2 Fushëveprimi**

**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

**Neni 28 Specifikimet teknike**

**Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie të Kontratave**

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

**Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**

**Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**

**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

**Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### **Pretendimi 1**

Sa i përket KAPACITETIT TEKNIK DHE PROFESIONAL (KONTRATAT 9 MILION EURO): "Ankimuesi dhe Eksperti Shqyrtues kanë pretenduar gabimisht se konsorciumi ynë nuk ka dëshmuar transaksionet bankare për referencat e prezantuara .

Ky pretendim bie poshtë plotësisht nga ana faktike. Autoriteti Kontraktues, përmes 'Letrës Standarde për Sqarimin e Tenderit' të datës 16.02.2026 (të cilën e bashkëngjisim si provë), ka kërkuar zyrtarisht pasqyrat bankare shtesë për këto projekte. Konsorciumi ynë i është përgjigjur kësaj kërkesë zyrtare brenda afatit, duke ofruar të gjitha dëshmitë e transaksioneve

bankare që mbulojnë vlerat e deklaruara. Autoriteti Kontraktues i ka verifikuar dhe aprovuar këto dëshmi, duke konstatuar se konsorciumi ynë ka përmbushur plotësisht kriterin prej mbi 9,000,000.00 € për punë ndërtimore në tri vitet e fundit. Rrjedhimisht, kjo pikë është e sqaruar, e shëruar ligjërisht dhe e mbyllur përpara vendimit për dhënie të kontratës."

Andaj Përmbushja e Kapacitetit Profesional: Konsorciumi ynë ka dëshmuar me dokumentacion të rregullt realizimin me sukses të kontratave të punëve ndërtimore në vlerë prej mbi 9,000,000.00 euro, kërkesë kjo që është shqyrtuar, verifikuar dhe aprovuar plotësisht nga Autoriteti Kontraktues si e rregullt dhe konform Dosjes së Tenderit.

## Pretendimi 2

"Na lejoni të theksojmë një shkelje të rëndë ligjore të bërë nga ankimuesi dhe e përsëritur gabimisht nga Eksperti Shqyrtues. Të njëjtit pretendojnë se konsorciumi ynë ka dështuar sepse nuk ka prezantuar 'transaksione bankare të faturave për pajisjet'.

Ky pretendim është në kundërshtim flagrant me parimet bazë të LPP-së (Neni 7 dhe 56).

Në Dosjen e Tenderit, për sa i përket listës së pajisjeve (Aneksi 7), Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar në asnjë rresht transaksione bankare apo dëshmi të pagesave për blerjen/qiranë e makinerive, sipas kërkesës nr. 6 dhe Dëshmitë për kërkesën nr. 6

2	Kompresor ajri me peshe min. 800 kg	2	2	1.Gjendja e pajisjes:Në rregull 2. Në Pronsi:Trasing Group Sh,p,k, Me M 1.Gjendja e pajisjes:Në rregull 2. Në Pronsi:BD TRADE Sh,p,k, Me Ma
13	Eskavator me zinxhire me peshe min 43 ton	1	1	1.Gjendja e pajisjes:Në rregull 2. Në Pronsi:BM GROUP SH.P.K
14	Eskavator me zinxhire dhe me goma montuese me korp i pajisur me laser me pesh min 24.7 ton.	1	1	1.Gjendja e pajisjes:Në rregull 2. Në Pronsi:BM GROUP SH.P.K
17	Viç për ndërtim te larte	1	1	1.Gjendja e pajisjes:Në rregull 2. Në Pronsi:BM GROUP SH.P.K

Te gjitha këto paisja sipas pretendimeve te ankimuesi dhe e përsëritur gabimisht nga Eksperti Shqyrtues qe po vertetohet se nuk I ka verifikuar Eksperti Shqyrtues, vetem I ka perseritur pretendimet e ankimusit ju lutemi shikoni - **Sqarimet për OE - Ndertimi i Objektivit te MBPZHR APK DHE AZHB te datës 22.10.2025.**

## Pretendimi 3

MARRVESHJA PER THEMELIM TE GRUPIT : Të gjitha nënshkrimet e prezantuara në ofertë nga anëtari "N & B" SH.P.K. janë bërë me miratimin dhe në koordinim absolut me Liderin e Grupit BM GROUP SH.P.K. Për më tepër, vetë marrëveshja jonë e themelimit (Aneksi 9, Faqja 5, Pika f-b) specifikon se anëtari është përgjegjës dhe ka të drejtë për ofrimin e dokumenteve mbështetëse për kapacitetin profesional dhe teknik për pjesën e tij. Nuk ka asnjë tejkallim autorizimi apo shkelje të Nenit 71 të LPP-së.

## Pretendimi 4

Lista e Zezë: Është pezulluar me Aktvendim të Gjykatës Komerciale (Lënda 2026:062567).

Sa i përket statusit të përshtatshmërisë, Gjykata Komerciale e Kosovës me Aktvendimin KA.nr.123/2026 ka pezulluar ekzekutimin e vendimit të OSHP-së për diskualifikim. Ky aktvendim është i prerë dhe i obligueshëm për t'u zbatuar nga OSHP, duke e konfirmuar konsorciumin tonë si plotësisht të përshtatshëm për lojën e prokurimit publik.

Për këto arsye, kërkojmë që ankesa e OE ankimues të refuzohet si e pabazuar dhe të lihet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpërbllimin tonë me kontratë.

## **Pretendimi 5**

Kërkesa 4 Operatori ekonomik duhet të dëshmoj Stafin Teknik (mbështetës OE 'R & Rukolli' ka paraqitur kërkesën 4.6 dy personave të ndryshëm, ku kërkesa ka qenë Minimum 1 (një) person të çertifikuar fasader, në Dosjen e Tenderit është kërkuar në mënyrë të qartë angazhimi i fasader moler, si profil specifik profesional. Në ofertën tuaj është paraqitur një dy personave të ndryshëm, **Albion Prokshi si fasader Skelist dhe Skender Koci Moler - Ngjyrëpunues**, i cili nuk përputhet me kërkesën e specifikuar në Dosjen e Tenderit.

Lidhur me **kërkesën 4.6 të Dosjes së Tenderit "Minimum 1 (një) person të çertifikuar fasader moler"**, Autoriteti Kontraktues dhe Paneli Shqyrtues kanë aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi për operatorë ekonomikë të ndryshëm, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Nga dokumentacioni dhe arsyetimi i Autoritetit Kontraktues rezulton se për operatorë ekonomikë të caktuar është konsideruar se profili "fasader moler" është një profil specifik profesional dhe se çdo devijim nga ky profil paraqet mosplotësim të kriterit. Autoriteti Kontraktues ka deklaruar shprehimisht se kërkesat lidhur me stafin profesional janë kërkesa substanciale dhe nuk mund të trajtohen si devijime të vogla.

Megjithatë, në rastin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, i njëjti kriter është interpretuar ndryshe, duke u konsideruar i përmbushur përmes dy personave të ndryshëm, respektivisht Albion Prokshi si fasader Skelist dhe Skender Koci Moler - Ngjyrëpunues.

Ky interpretim bie ndesh me formulimin e vetë kriterit, i cili kërkon "Minimum 1 (një) person të çertifikuar fasader moler". Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se pozita mund të mbulohet nga dy persona të ndryshëm, atëherë i njëjti standard është dashur të aplikohet për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Pranimi i një interpretimi fleksibil për operatorin ekonomik të rekomanduar dhe aplikimi i një interpretimi strikt për operatorët e tjerë përbën trajtim të pabarabartë dhe cenon parimet themelore të prokurimit publik.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues në përgjigjet e tij ka deklaruar se kërkesat për stafin profesional nuk mund të konsiderohen devijime të vogla dhe nuk mund të zëvendësohen me profile të tjera profesionale. Rrjedhimisht, AK dhe Paneli Shqyrtues nuk mund të aplikojnë dy standarde të ndryshme për të njëjtin kriter.

Andaj kërkojmë që OSHP të konstatojë shkeljen e nenit 7 të LPP-së, për shkak të aplikimit të standardeve të dyfishta gjatë vlerësimit të kërkesës 4.6 dhe të urdhërojë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e publikuara në Dosjen e Tenderit.

## **Pretendimi 6**

Përveç që ankesa e OE 'R & Rukolli' është e pabazuar ndaj nesh, na lejoni të njoftojmë Panelit Shqyrtues se vetë ky operator ankimues ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme duke shkelur kriteret kualifikuese të Autoritetit Kontraktues, specifikisht Aneksin 1 (Specifikimet Teknike të Detyrueshme):

Mosdeklarimi i Afatit Kohor: Dosja e Tenderit ka përcaktuar si kriter të detyrueshëm që OE të deklarojë **me deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur se i përshtatet afatit maksimal prej max. 36 muajsh kalendarik për përfundimin e tërësishëm të punimeve**. OE 'R & Rukolli' ka dështuar të dorëzojë këtë deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur, duke shkelur një kriter eliminues të dosjes.shih Aneks 1, **Shënim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku është vlerësuar maksimumi i afatit për implementim të këtij projekti max. 36 muaj kalendarik.**

**Afati kohor i planifikuar i përfundimit të tërësishëm të punimeve përfshirë pranimin e përkohshëm të punimeve dhe pranim-dorëzimin e objektit duhet të jete jo me shume se 36 muaj kalendarik. OE duhet të deklaroj me një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur.**

Mungesa e Planit Dinamik të Detajuar: Sipas Aneksit 1, çdo OE ka qenë i obliguar të dorëzojë **Planin Dinamik të Detajuar të punimeve konform normave dhe standardeve ndërtimore**. OE 'R & Rukolli' nuk ka prezantuar Planin Dinamik të Detajuar.

Sipas vendimit të OSHPs në Përgjigje në pretendimin e III: këtyre standardeve, gjë që e bën ofertën e tyre të pakompletuar teknikisht pasi , Planin Dinamik të Detajuar ashtu siç është paraparë në dosjen e tenderit , nuk ka ofruar Planin Dinamik të Detajuar sipas Paramases dhe parallogaris, OE 'R & Rukolli' ka prezantuar vetem ndarjen sipas fazave ( arkitekturë, elektrikë, makineri, hidrotetnik) një plan dinamik shabllon, plani i ofruar konsideroj se nuk e përmbush kriteret minimale të përcaktuara në dosje të tenderit sipas Aneksit 1.

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues dhe ka pasur kërkesë të prerë dhe eliminuese dorëzimin e "ANEKSI 1 - SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME", përmes të cilit **OE duhet të ofrojë garancion për punimet për një periudhë prej 365 ditësh pas pranimit të punëve**. Ky aneks duhej të dorëzohej i nënshkruar dhe i vulosur. Mungesa e Dokumentit nga OE i Shpallur Fitues, **OE 'R & Rukolli**, në ofertën e tij të dorëzuar në platformën e-Prokurimi nuk e ka prezantuar fare këtë deklaratë (Aneksin 1), ose e ka dorëzuar atë të paplotësuar / pa nënshkrim dhe vulë. Natyra Eliminuese e Shkeljes (Neni 59 i LPP-së): Sipas Nenit 59, paragrafi 2 i LPP-së, Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë apo të pranojë asnjë ndryshim material në ofertë pas hapjes së tenderit. Garancia e punimeve prej 365 ditësh prek elementet thelbësore teknike dhe financiare të kontratës. Mungesa e saj e bën ofertën e OE-së fitues të papërgjegjshme dhe administrativisht të paasimilueshme. AK nuk ka pasur asnjë të drejtë ligjore ta tolerojë këtë mungesë apo të kërkojë sqarime për një dokument që mungon tërësisht.

OE 'R & Rukolli' këtë kërkesë të AK nuk e ka përmbushur dhe Mungon Titulli i Kontrates dhe Numri i Prokurimit në këtë Aneksin 1 (Specifikimet Teknike të Detyrueshme): të cilat Mungojnë:

- **Deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur se i përshtatet afatit maksimal prej max. 36 muajsh kalendarik për përfundimin e tërësishëm të punimeve**
- **Planin Dinamik të Detajuar të punimeve konform normave dhe standardeve ndërtimore**
- **Garancion për punimet për një periudhë prej 365 ditësh pas pranimit të punëve**
- Pasi AK e ka shpallur fitues **OE 'R & Rukolli** me Vendim të OSHP-së dhe ja ka pranuar një plan dinamik shabllon, kinse e përmbush kriteret minimale të përcaktuara në dosje të tenderit sipas Aneksit 1, por **OE 'R & Rukolli**, në ofertën e tij të dorëzuar në platformën e-Prokurimi nuk e ka prezantuar fare këtë **deklaratën e pranim-dorëzimin e objektit duhet të jete jo me shume se 36 muaj kalendarik dhe Garancion për punimet për një periudhë prej 365 ditësh pas pranimit të punëve sipas (Aneksin 1)**, Por ka ofruar një Deklaratë ku nuk ceket as Deklaratë të nënshkruar dhe e vulosur se i përshtatet afatit maksimal prej max. 36 muajsh kalendarik për përfundimin e tërësishëm të punimeve dhe as Garancioni për punimet për një periudhë prej 365 ditësh pas pranimit të punëve.

R & Rukolli SH.P.K.  
Rr. "18 Qershori" Skenderaj  
Tel: 049/309-213  
Numri Unik: 810618366

## **DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME**

Deklaroj me përgjegjësi morale, materiale si dhe para organeve perkatëse  
gjyqësore se të gjitha punimet do t'i kryejm konform specifikacionit teknik në dosjen e  
tenderit.

Ndërtimi i objektit të MBPZHR-së, AZHB-së dhe APK-së  
203-25-8175-5-1-1

Me 16.01.2026



### **ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Shënim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore,  
ku është vlerësuar maksimumi i afatit për implementim të këtij projekti max. 36 muaj kalendarik.

Afati kohor i planifikuar i përfundimit të tërësisë së punimeve përfundim pranimit e përkohshëm të punimeve  
dhe pranimit-dorëzimit të objektit duhet të jetë jo më shumë se 36 muaj kalendarik. OE duhet të deklaroj me një  
deklarate të nënshtuar dhe vëlozur.

OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, Planin Dinamik të Detajuar.

Plani dinamik duhet të jetë konform normave dhe standardeve ndërtimore.

Pjesa kryesore e projektit publikohet si Aneksi shtesë, ndërsa si tërësi për shkak të volumit të madh mund ta  
tërhiqni me "CD" në MBPZHR Adresa: Ndërtimtaria Nderimtare e ish Ramiz Sadikut Rr.: "Ukshin Hoti" nr.120, kati i VI-të

OE duhet të ofroj Garancion të punimeve 365 ditë pas pranimit të punëve nga ana e autoritetit kontraktues. OE  
duhet të deklaroj me një deklarate të nënshtuar dhe vëlozur.



### **Pretendimi 7**

OE ka paraqitur një vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dokumente marrvëshje me Administrata Tatimore e Kosovës, mirëpo nuk ka dorëzuar dëshmi për pagesat obligimeve perkatëse për muajt:

- Dhjetor 2025;
- Janar 2026;
- Shkurt 2026;
- Mars 2026;
- Prill 2026.

**Kërkojm nga Organi Shqyrtues te Prokurimit në kuadër të procesit të verifikimit dhe sqarimit të vërtetimit nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dokumente marrveshje me Administrata Tatimore e Kosovës me OE 'R & Rukolli', nese ju ka përmbajët marrveshjes se pagesave te tatimeve sipas marrveshje me Administrata Tatimore e Kosovës.**

**Sipas informatave tona OE 'R & Rukolli është i bllokuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.**

#### **Kërkesa ndaj Panelit Shqyrtues të OSHP-së**

Bazuar sipas shkeljeve më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së:

- Ta aprovojë këtë ankesë si **të bazuar**.
- Ta anulojë Njoftimin për Dhënie të Kontratës të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.
- Ta shpallë Operatorin Ekonomik '**R & Rukolli**, si të papërgjegjshëm për shkak të mungesës së plotësimit kritereve dhe kërkesave nga AK .
- Ta kthejë lëndën në **Rivlerësim**, duke urdhëruar AK-në që të zbatojë Kërkesat dhe Kriteret e Përcaktuara në Dosje.

Bashkangjitur gjeni :

- 1.B05 Njoftim per Kontrat
- 2.B58 Njoftimi mbi vendimin e AK 29.05.2026
- 3.Vendimi i Gjykates Komerciale N&B
4. Marveshje me ATK (04.06.2025) Rukolli
5. Vertetimi nga ATK Rukolli
6. Raporti\_Ekspertit\_2026 0170
7. Vendimi OSHP 2026 162
8. Sqarimet për OE - Ndertimi i Objektivit te MBPZHR APK DHE AZHB22.10.2025

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*